



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	29. 06 2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMBICK	3372/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.482/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1112/19 të datës 27.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.178/2019 të datës 08.03.2019 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike “Mos zbatim i vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.178/2019 e datës 08.03.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.KZKA-3/2019 i datës 08.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

III. Obligohet Drejtorit Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ia lëshuar ankueses Akt Emërimin për pozitën e punës Kryesuese e Njësisë së Shkresave Gjyqësore, sipas konkursit të brendshëm të datës 13.11.2018.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil, me datë 13.11.2018 ka aprovuar kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për shpalljen e konkursit të brendshëm për pozitën “Kryesues i Njësisë së Shkresave Gjyqësore” me Nr. Ref.22a/2018. Pas marrjes së autorizimit, Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 13.11.2018, ka publikuar konkursin për rekrutimin e pozitës Kryesues i Njësisë së Shkresave Gjyqësore.

Ankuesja në konkursin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të shpallur me datë 13.11.2018, ka aplikuar dhe e njëjta ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit. Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, me datë 11.12.2018 ka rekomanduar për emërim kandidaten Nevgize Krasniqi.

Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me datë 20.12.2018 ka nxjerr Vendimin me numër DM 701/2018 me të cilin ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën “Kryesues i Njësisë së Shkresave Gjyqësore” pranë Departamentit të Administratës, duke u bazuar në nenin 11 paragrafit 1 të Ligjit Nr.03-L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 18 paragrafit 1 të po këtij ligji, me arsyetimin se komisioni vlerësuar nuk ka qenë objektiv me rastin e vlerësimit.

Ankuesja, e pa kënaqur me Vendimin e datës 20.12.2018 të Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me datë 18.01.2019 ka parashtruar ankesë me Nr.248 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 08.02.2019 përmes Vendimit Nr.KZKA-3/2019 ka aprovuar si të bazuar ankesa e ankueses dhe ka shfuqizuar Vendimin me numër DM 701/2018 të datës 20.12.2018 të Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ankuesja, e pa kënaqur me mos zbatimin e Vendimit të datës 08.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me datë 08.03.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Këshilli, me datë 21.03.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 27.05.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1112/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 08.03.2019 të parashtruar nga ankuesja Nevgize Krasniqi.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesve e datës 08.03.2019 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 08.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Ankesa e ankueses e datës 18.01.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Vendimi i datës 20.12.2018 i Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; E-mail i datës 07.12.2018; 04.12.2018; Miratimi nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti për Shërbimin Civil e datës 13.11.2018; Raporti njoftues V.nr.340/2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi për publikim të konkursit e datës 29.08.2018 e lëshuar nga Ministria e Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil; konkursi i datës 31.10.2018; Vendimi i datës 14.09.2018 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Rekomandimi i datës 20.09.2018 për rishpallje të konkursit; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë të datës 20.09.2018; Rishpallja e konkursit e datës 13.11.2018; Vendimi i datës 29.11.2018 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë e datës 03.12.2018; Lista e aplikantëve dhe lista e ngushtë; Testi me shkrim 06.12.2018; Vlerësimi individual i kandidatëve; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues; Rekomandimi për emërim; Vendimi i datës 20.12.2018 i Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; E-mail i datës 20.12.2018; 21.12.2018; Vendimi i datës 29.11.2018 për Themelimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Rekomandimi për emërim; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Vendimi me numër DM 117-2019 i datës 08.03.2019 i Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit; Aplikacioni për punësim i kandidatës me dokumentacionin e bashkangjitur si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punesimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kërkesën e datës 06.05.2019 të ankueses; Përgjigjen në kërkesë e datës 06.05.2019; Njoftimin lidhur me ankesën i datës 22.08.2019; Njoftimin nga ankuesja i datës 10.02.2021 dhe Aktgjykimin A.nr.1112/19 të datës 27.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e bazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses e cila ka kërkuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të detyrohet Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që të zbatoj vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me Nr.KZKA-3/2019 të datës 08.02.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. KZKA-3/2019 të datës 08.02.2019, ka shqyrtuar në tërësi procedurën e rekrutimit për pozitën "Kryesues i Njesisë së Shkresave Gjyqësore" duke konstatuar që e gjithë procedura është zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe



nuk ka gjetur parregullsi gjatë vlerësimit të kandidatëve, mbi bazë të kësaj ka aprovuar ankesa e ankueses dhe ka shfuqizuar Vendimi DM-701/2018 të Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kolegji, po ashtu bazuar në shkresat e administruara të lëndës, ka konstatuar se procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. KZKA-3/2019 të datës 08.02.2019 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike duke vepruar kështu në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin N.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.482/2021

Avdyll BEKTESHI

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivoit të KPMSHCK-së.